



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE  
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE  
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 4696 Prot.

Tiranë, më 12 .09.2014

**URDHËR**  
Nr. 1499 , datë 12 . 9 .2014

**PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME**  
**TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT**  
**TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Në mbështetje të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të vendimit nr.55/2014, datë 31.07.2014 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të ILDKPKI-së”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Rregullore së Brendshme të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
2. Ngarkohen të gjithë punonjësit e ILDKPKI për zbatimin e Rregullore së Brendshme.
3. Moszbatimi i dispozitave të Rregullore së Brendshme passjell përgjegjësi disiplinore dhe administrative.
4. Rregullorja e Brendshme e miratuar me Urdhërin Nr.554, datë 29.12.2009 shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**  
**Shkëlqim GANAJ**

